

SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT ADMINISTRATA FISKALE, PRODUKTIVITETI DHE INOVACIONI

MBLEDHJE E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE
Tiranë, 26 mars 2024

OBJEKTI DHE
METODOLOGJIA


GJETJE
KRYESORE

REKOMANDIME




VIZIONI I POLITIKËS FISKALE

DRAFT - Strategjia Afatmesme e të Ardhurave 2022 “parashikon heqjen graduale të përjashtimeve dhe stimujve të parashikuara duke nënvizuar 6 prioritetet e saj, mes të cilave edhe uljen e hendekut të përputhshmërisë së TVSH”.



ERP 2024 – 2026

Programi i fundit i Reformave Ekonomike - tre grupime tematike, fokusuar në kapitalin njerëzor dhe politikat sociale, qëndrueshmërinë dhe rimëkëmbjen, dhe konkurrueshmërinë (Growth plan).



VLERËSIME NGA RAPORTET NDËRKOMBËTARE

RAPORT PROGRESI BE - *sfidat kryesore të vazhdueshme që dëmtojnë klimën e biznesit janë: korrupsioni; ekonomia informale dhe konkurrenca e pandershme; mungesa e parashikueshmërisë së legjislacionit; burokracia, një mekanizëm joefikas i konsultimit publiko-privat.*

TADAT – *“sfida, duke përfshirë nevojën për të rritur profesionalizmin në funksionin e kontrollit dhe Zyrën e Tatimpaguesve të Mëdhenj, një angazhim më të madh të jashtëm me ndërmjetësit dhe përfaqësuesit kryesorë të biznesit, mungesën e mekanizmave të rëndësishëm të reagimit nga palët e interesuara dhe nevojën për të adresuar mangësitë në kuadrin ligjor të rishikimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore”.*

FMN - *“konsolidimi duhet të arrihet përmes një strategjie të shëndoshë të mobilizimit të të ardhurave, së bashku me përfitimet e efikasitetit dhe rialokimin e burimeve në infrastrukturë, arsim dhe përshtatje klimatike.”*

OECD - *Sipas Indeksit të Politikave të OECD-së për SME-të - Shqipëria përballet me disa mangësi në konkurrueshmëri dhe Informaliteti shquhet si një pengesë kryesore për avancimin e qëndrueshëm të bizneseve formale dhe rrjedhimisht të ekonomisë në përgjithësi.*

BERZH - *“problemi themelor për vendet e Ballkanit është produktiviteti i ulët në ekonomi, rezultat i shumë viteve të nën-investimit, institucioneve të dobëta, demografisë së pafavorshme dhe një mjedisi të vështirë biznesi.*

Ekzistojnë pabarazi të konsiderueshme midis konkurrueshmërisë së Shqipërisë dhe partnerëve rajonalë dhe të BE-së:

- ✓ ekspertizë/dije e kufizuar sipërmarrëse dhe teknologjike
- ✓ kërkesat e paplotësuara për investime si në kapitalin njerëzor ashtu edhe në atë fizik
- ✓ nivelet e vazhdueshme të ulëta të shpenzimeve për kërkimin dhe zhvillimin
- ✓ një mungesë në rritje e fuqisë punëtore të kualifikuar

të cilat pengojnë konkurrueshmërinë e Shqipërisë.

Indeksi Global i Inovacionit - Renditja në nivel botëror

Shqipëria renditet e fundit në rajon

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
SRB	70	65	58	56	57	53	54	55	53
MNE	40	46	52	55	45	49	50	60	75
ALB	112	71	115	83	70	83	84	84	83
MKD	55	62	63	84	59	57	59	66	54
BIH	122	104	86	68	71	74	75	70	77

Indeksi Global i Inovacionit – Kërkimi dhe kapitali njerëzor, Sofistikimi i Tregut, Njohuri dhe prodhimi teknologjik dhe Prodhimi Kreativ fushat më problematike

– Shqipëria renditet më poshtë se rajoni

	Institucionet	Kërkimi dhe Kapitali njerëzor	Infrastruktura	Sofistikimi i Tregut	Sofistikimi i biznesit	Njohuri dhe prodhimi teknologjik	Prodhimi kreativ
SRB	57	51	35	41	68	41	92
MNE	82	62	56	54	66	80	85
ALB	60	96	53	93	50	91	87
MKD	75	78	40	30	60	53	69
BIH	104	68	67	27	106	64	91

- ✓ *Stimulojë debatin mbi sfidat aktuale të përmirësimit të produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë.*
- ✓ *Identifikojë ndërhyrje në fushën e politikave ekonomike, politikave fiskale dhe administrimit fiskal që do të nxisin produktivitetin dhe konkurrencën e ekonomisë.*

Diskutimi njih kontributin e praktikave më të mira të fiskalizimit dhe ofrimit të shërbimeve elektronike publike si baza e përmirësimit të produktivitetit në pesëvjeçarin e fundit dhe synon të identifikojë, në dialog me palët e interesuara, iniciativa dhe ndërhyrje politike me impakt të ngjashëm në ekonomi.

Në vëmendje të politikëbërjes duhet të jetë administrimi efikas i të të ardhurave buxhetore dhe menaxhimi i tyre në funksion të përmirësimit të produktivitetit duke nxitur inovacionin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale.

PROBLEMATIKA/SUGJERIME TË NMVM-ve

1. Kuadri Ligjor

– shumë ndryshime pak qëndrueshmëri:

- Procedurat tatimore dinamike (mos ndoshta ka ardhur koha të strukturohen në një bosht të vetëm (e-tax/fiskalizimi, aksionet anti-info? A inkurajojnë vetëdeklarimin apo rivlerësimet?)
- Ligji tatimi mbi te ardhurat - a strukturon zgjidhjet apo krijon probleme të reja? (ndryshime/kontestime nga grupet e interesit)
- Skema e kompensimit të TVSH për fermeret ndryshon gjithmonë (mungon një zgjidhje e qëndrueshme)
- në disa raste favorizon info (p.sh. akciza)

2. Administrimi tatimor

- përpjekje të reja-probleme të vjetra:

- Metodologjia e kontrolleve dhe afatet e zgjatura
- kapacitete të kufizuara dhe rivlerësime tatimore jo të qarta
- Ndryshimet ligjore dhe presioni i kohës mbi administratën për t'u përgatitur nga ana operacionale (p.sh u shty afati për përgatitjen e formularëve sipas ligjit të ri "Për Tatimin mbi të Ardhurat")
- Procedurat e mbylljes së biznesit ende problem edhe kur ligji është i qartë (QKB të cregjistron/DPT të mban tatimpagues)
- Trajtimi i DTT (problem madhor dhe udhëzim i vjetër)- qasje individuale apo ndryshime strukturore që t'i përgjigjen tregut në hapje dhe sfidave që sjell?

3. Informaliteti

- Përpjekje në vazhdimësi por perceptim për rritje (mosdeklarim, mos regjistrim)
- Qasje të integruara sektoriale (rritin cilësinë dhe standardet—të rregullojmë tregun në kuadër të integritimit në BE dhe ulim informalitetin (p.sh. turizëm, transport- jo aksione....))

4. Klima e biznesit

- Kreditimi i shtrenjtë (skemat e AIDA të pezulluara)
- kosto të larta për biznesin e vogël (kosto e certifikatës së nënshkrimit elektronik)
- inspektimet nga inspektoriatet problem në frekuencë dhe cilësi
- siguria e të dhënave (e-albania)
- A koordinohen politikat me masat që zbatohen dhe kur zbatohen?

5. Produktiviteti & Konkurrueshmëria

- Ndërprerje të energjisë
- Mungesë specialistesh/ekspertize

Hulumtime & Analiza

- Raportet, kombëtare dhe ndërkombëtare, ligje/akte nënligjore
- Analiza të të dhënave zyrtare nga burimet dytësore
- **Sinteza** e gjetjeve dhe rekomandimeve të deritanishme
- **Puna e deritanishme e Sekretariatit** mbi problematikat në tregun e punës






Konsultime


- **Takime konsultative (17)** me institucione qendrore, biznese, studio audituese dhe shoqata biznesi
- **Komente nga Anëtarë dhe Partnerë të KI**
Shoqata e Turizmit
Shoqata e Ndërtuesve
Dhoma e Tregtisë Durrës

Pyetësor

- **Pyetësor i strukturuar** (dërguar online)
- **Fokusi – sfidat e sektorit privat** në drejtim të Mirëadministrimit Fiskal, Informalitetit, Produktivitetit dhe Inovacionit.
- **U morën 601 përgjigje anonime**

ANKETA E KI: PROFILI I KOMPANIVE






2. GJETJE


2.1 GJETJE – ADMINISTRIMIN FISKAL/KOMUNIKIMI

- Ndërsa ekziston një konsensus për përmirësimin e komunikimit dhe ndërveprimit me administratën tatimore qendrore.
- Sektori privat mbetet i shqetësuar për stabilitetin e politikave fiskale, cilësinë e komunikimit fiskal (vendimi tatimor)/interpretimi teknik i legjislacionit dhe profesionalizmi i administratës.

Si do ta vlerësonit ju ndryshimin e komunikimit të administratës tatimore në dy vitet e fundit




A keni marrë pjesë në sesione trajnimi të ofruara gjatë viteve të fundit nga Administrata Tatimore mbi zbatimin e legjislacionit tatimor?




2.2 GJETJE - ADMINISTRIMI FISKAL/FISKALIZIMI

- Sektori privat e ka përqafuar pozitivisht dixhitalizimin, duke shprehur kënaqësinë e përgjithshme me shërbimet elektronike. Gjithashtu vlerësojnë pozitivisht platformën qendrore të faturave të administratës tatimore (fiskalizimi), duke nxjerrë në pah rëndësinë dhe stimulimin e edukimit fiskal, veçanërisht për NMVM-të të prezantuar nga ky sistem për tatimpaguesit.
- Megjithatë, ka ende vend për përmirësim, veçanërisht në rritjen e besueshmërisë së të dhënave dhe elementeve të shërbimit ndaj klientit.


Vlerësoni kënaqësinë me shërbimet elektronike të drejtorisë së përgjithshme të tatimeve (i kënaqur/shumë i kënaqur)



A mendoni se shërbimi tatimpagues/procesi i fiskalizimit/etj ka nevojë për ngritjen e një shërbimi elektronik me telefon (call centre)?




A ka ndikuar Fiskalizimi kostot e administrimit fiskal?




2.3 GJETJE - INFORMALITETI

- Pavarësisht përpjekjeve për formalizimin e ekonomisë, bizneset ende ruajnë një perceptim të lartë të informalitetit.
- Sektorët - bujqësia, tregtia dhe shërbimet konsiderohen si më problematikët.

Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni?





Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni?



2.4 GJETJE - INFORMALITETI

- Evazioni fiskal konfirmohet si forma kryesore e shfaqjes së informalitetit në vite, e ndjekur nga puna e padeklaruar dhe mosregjistrimi.
- Konkurrenca e pandershme - si faktori kryesor që nxit informalitetin, por ky perceptim ka mbizotëruar deri në vitin 2024, ku ajo u zëvendësua nga barra fiskale në nivel qendror.


*Për secilin nga faktorët e renditur identifikoni shkallën e influencës në vendimin e një biznesi për të ndërmarrë riskun e një aktiviteti informal
2022 - 2024*




2.5 GJETJE - INFORMALITETI - FISKALIZIMI

- Bizneset - shqetësim nëse ligji i të ardhurave i miratuar së fundmi do të rrisë potencialisht informalitetin.
- Në të kundërtën, diskriminimi pozitiv në tatimin e aktivitetit të biznesit mund të ndihmojë në zvogëlimin e nivelit të informalitetit, siç është rasti me uljen e TVSH në sektorin e turizmit.
- Bizneset perceptojnë sistemin e fiskalizimit si një mjet për të luftuar informalitetin.


Si mendoni se do të ndikojë në shkallën e informalitetit në sektorin tuaj zbatimi i ligjit të ri mbi të ardhurat?



Në fushën e Turizmit ku disa shërbime kanë përfutur ulje të TVSH-së në 6%, mendoni se kjo politikë ka sjellë uljen e informalitetit në këtë sektor? - SEKTORI I TURIZMIT




A mendoni që Fiskalizimi ka adresuar si duhet zbatimin në praktike të politikave fiskale dhe masat për formalizimin e ekonomisë?




2.6 GJETJE - PRODUKTIVITETI

- Kompanitë në vend perceptojnë nivele të ngjashme produktiviteti krahasuar me konkurrentët e tyre vendas.
- Megjithatë, ata kanë një pikëpamje pesimiste për nivelin e tyre të produktivitetit kur krahasohen me konkurrentët që operojnë në tregjet rajonale dhe më gjerë.
- Kjo dobësi potencialisht pengon aftësinë e kompanive shqiptare për të konkurruar në mënyrë efektive në tregjet e përbashkëta rajonale dhe më të gjera.

Duke përkufizuar produktivitetin e punes si vlerën (monetare) që merr kompania nga një ditë pune e punonjësve tuaj, si do ta vlerësonit ju produktivitetin e tyre në raport me atë të kompanive të tjera në sektorin ku operoni:




Duke përkufizuar produktivitetin e punes si vlerën (monetare) që merr kompania nga një ditë pune e punonjësve tuaj, si do ta vlerësonit ju produktivitetin e tyre në raport me atë të kompanive të huaja, me të cilat bashkëpunoni:



2.7 GJETJE, PRODUKTIVITETI - SEKTORËT

- Produktiviteti, qoftë si perceptim qoftë i matur si vlera e shtuar për njësi të punës, ka një dimension sektorial shumë të rëndësishëm për t'u kuptuar dhe pasqyruar në politikat ekonomike/fiskale.
- Sektorët tradicionalë bujqësia dhe ndërtimi, industria, tregtia kanë shkallë të lartë të unifikimit të produktivitetit – kjo nënkupton sektorë të maturuar, me strukturë konkurruese dhe pak hapësira për ndryshime strukturore.
- Energjia dhe ICT, Shërbimet Profesionale – sektorë me strukturë sektoriale që dominohet nga kompani lider në produktivitet, sektorë të rinj (jo të maturuar) dhe me hapësira për të tërhequr investime.


Perceptimi i Kompanive mbi Produktivitetin Krahasuar me Konkurrentët




2.8 GJETJE, Produktiviteti i Punës

- Produktiviteti, vlerësuar si vlera e shtuar për një të punësuar, është 11 888 Euro/Vit.
- Gjatë 2019-2022, produktiviteti i punës u rrit me normën mesatare vjetore prej 11%.
- Sektorët me produktivitetin e punës më të lartë janë industria nxjerrëse, energjia, shërbimet profesionale, pasuritë e palujtshme dhe TIK.
- Sektorët me rritjen më të lartë të produktivitetit të punës janë turizmi, industria përpunuese, industria nxjerrëse, sektori rekreacionit dhe çlodhjes.
- Sektorët si shëndetësia, administrimi publik, arsimiti, furnizimi me ujë dhe përpunimi i mbetjeve raportojnë rritje të produktivitetit të punës (crowding out effect nga investimet publike).
- Sektorët me produktivitet të lartë raportojnë norma rritjeje modeste; një ngadalësim të produktivitetit për sektorët si energjia, ICT si dhe sektori i ndërtimit.

Produktiviteti mesatar i punës për punonjës (në euro, vjetor 2019-2022)




Norma Mesatare e Ndryshimit të Produktivitetit të Punës për Punonjës (në %, vit pas viti 2019-2022)




2.9 GJETJE - INOVACIONI DHE TRAJNIME

- Kompanitë e njohin rëndësinë e inovacionit në rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës së tyre në tregje.
- POR vetëm një numër i vogël i kompanive (6%) ndajnë fonde në mënyrë specifike për K&ZH dhe trajnimin e punonjësve (16%).


C'farë vendi zë zhvillimi dhe futja e inovacionit (sa vëmendje i kushtohet) në kompaninë tuaj?



A ka kompania juaj një fond të dedikuar për Kërkim dhe Zhvillim?




A ka kompania juaj një fond të dedikuar për trajnimin e punonjësve?




2.10 GJETJE - KONKURRUESHMËRIA

- Në vitin 2024, disponueshmëria e fuqisë punëtore – prioritetizohet NR 1, ndaj të gjithë elementëve të tjerë që kanë të bëjnë me integrimin /konkurrencën e kompanive shqiptare.
- Nga faktorët indirektë, Informaliteti, Politikat Tregtare dhe Aksesit në Financim konsiderohen si pengesat kryesore për integrimin.

Nga faktorët e mëposhtëm, të lidhur direkt me kompaninë tuaj cilët mund të konsiderohen 3 pengesat kryesore në integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës:




Nga faktorët e mëposhtëm të lidhur indirekt me kompaninë tuaj, cilët mund të konsiderohen 3 pengesa kryesore në integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës:




2.11 GJETJE - BARRA RREGULLATORE DHE KLIMA E BIZNESIT

- Sipas perceptimit të biznesit, barra rregullatore është rritur gjatë tre viteve të fundit.
- Legjislacioni tatimor vlerësohet si fusha me ngarkesën më të madhe administrative për kompanitë, e ndjekur nga Inspektimet dhe shpeshtësia e Inspektimeve.

Si ka ndryshuar barra e përgjithshme rregullatore mbi biznesin tuaj gjatë tre viteve të fundit?




Cila nga fushat e mëposhtme shkakton një barrë administrative për ndërmarrjen tuaj, e matur orë pune dhe/ose kostove të shkaktuara?



2.12 GJETJE - KLIMA E BIZNESIT

- Bizneset e konsiderojnë regjistrimin e biznesit dhe procedurat e licencimit/autorizimit elementët më të favorshëm për të bërë biznes në Shqipëri.
- Megjithatë, procedurat dhe kostot e huamarrjes, barra fiskale dhe inspektimet janë ndër elementët më pak të favorshëm.

Si do ta vlerësonit ju klimën e të bërit biznes në sektorin ku ju operoni, bazuar në elementët e mëposhtëm





3. REKOMANDIME



- Përmirësim i komunikimit me administratën tatimore, kryesisht si rezultat i aksesit më të lehtë elektronik tatimor
- Shërbim më të mirë të klientit në lidhje me fiskalizimin
- Ndikimin e fiskalizimit dhe uljen e TVSH-së në turizëm në formalizimi i ekonomisë
- Uljen e kontrolleve tatimore
- Vlerësohet pozitivisht procesi i regjistrimit të biznesit dhe marrja e lejeve.

Por, kërkohen ndërhyrje të mirëmenduara dhe të matura për të trajtuar çështjet që lidhen me sigurinë e të dhënave, formalizimin (bujqësisë, tregtisë dhe shërbimeve), apo kostot e papritura për NVM-të lidhur me fiskalizimin, apo ndryshimet e shpeshta fiskale, taksimin e dyfishtë. Ndërkohë përsa i përket konkurreshmërisë në nivel firme, sipërmarrësit vendas mbështesin inovacionin, por në një pjesë të madhe, nuk shpërndajnë burime ose fonde për Kërkim dhe Zhvillim. Ata ende besojnë se janë konkurrues ne tregun vendas, ndërkohë që pranojnë që rritja e pagave në sektorin privat nuk erdhi për shkak të rritjes së produktivitetit të ndërmarrjeve tyre, por u stimulua nga iniciativa në sektorin publik. Fakti që “besojnë se janë konkurrues”, nuk e stimulon investimin në inovacion.

Në kushtet e hapjes së tregjeve dhe standardeve të reja, dhe uljes së produktivitetit, sigurisht që rritet rreziku i falimentit.

3.1 REKOMANDIME – VIZIONI POLITIK

Rekomandimi 1. Miratimi i Strategjisë për mbledhjen e të ardhurave si një dokument gjithëpërfshirës për të gjithë aktorët në sektorin publik dhe privat.

- *Strategjia duhet t'i nënshtrohet konsultimit dhe diskutimit paraprak me publikun. Dokumenti duhet të evidentojë qartë qëllimet, objektivat dhe ndërhyrjet afatmesme për të lehtësuar monitorimin e saj dhe llogaridhënien e institucioneve mbi përdorimin e parave të taksapaguesve. Strategjia nuk duhet të synojë vetëm mbledhjen e të ardhurave, por edhe rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë nëpërmjet administrimit më të mirë tatimor dhe shpërndarjes së drejtë të barrës tatimore. Strategjia duhet të harmonizojë objektivat me strategjitë sektoriale, Programin e Reformave Ekonomike 2024 – 2026 dhe Planit të Rritjes.*

3.2 REKOMANDIME - INOVACIONI

Rekomandimi 2. Për të stimuluar inovacionin e biznesit duke liruar fonde në nivel firme dhe për të nxitur investimet kapitale/teknologjike, duhen ndërmarrë analiza specifike duke u fokusuar në: (a) amortizimin e përshpejtuar, (b) amortizimin shtesë (c) njohja si shpenzime të zbritshme të sponsorizimeve dhe donacioneve për K&Zh.

Rekomandim 3. Koherencë e stabilitetit fiskal dhe konsolidim i procedurave tatimore përmes një ligji të ri.

- *Ligji i ri duhet të unifikojë të gjitha praktikat e procedurave tatimore të parashikuara aktualisht nga disa ligje, akte nënligjore dhe rregullore të zbatueshme në nivel qendror dhe lokal. Miratimi i ligjit të ri duhet të synojë miratimin e praktikave më të mira në lidhje me organizimin e aktiviteteve të administratës tatimore siç parashikohet nga OECD dhe duhet të shoqërohet me një Udhëzues të detajuar që parashikon vendime të qarta tatimore, të zbatueshme drejtpërdrejt për skenarët e biznesit. Pa paragjykuar opsionet në dispozicion të ligjvënësve, ligji i ri duhet të jetë rezultat i një marrëveshjeje politike gjithëpërfshirëse dhe në shkallë të gjerë, dhe mundësisht në nivel Kodi (si p.sh. Kodi Doganor).*

3.4 REKOMANDIME - PROCEDURA

Rekomandim 4. Miratimi i një udhëzimi të ri për marrëveshjet dypalëshe për shmangien e taksimit të dyfishtë përmes automatizimit dhe procedurave elektronike të ndjekura nga bizneset dhe administrata tatimore (si p.sh. sistemi i rimbursimit të TVSH-së)

- *Zgjidhja e parashikuar nga udhëzimi nuk duhet domosdoshmërisht të bazohet në një procedurë të mirëfilltë, por t'i referohet e të ndjekë modele të vendeve të BE-së dhe të përditësojë marrëveshjet bazuar në formatet e reja të dokumenteve të lëshuara nga Departamentet Evropiane të Taksave, si për shembull të njihen Certifikatat e Rezidencës të lëshuara në formë elektronike, pa nënshkrime origjinale dhe vula të njoma. Kjo duhet zbatuar me rigorozitet përmes një ekipi të përkushtuar ekspertësh në nivel DPT.*

3.5 REKOMANDIME - PRODUKTIVITETI

Rekomandim 5. Duke pasur parasysh ndërveprimin ndërmjet politikës fiskale, inovacionit dhe produktivitetit, rekomandohet që produktiviteti të jetë në themel të hartimit të politikës fiskale dhe mbështetje direkte për Kërkim-Zhvillim/Novacion.

- Për më tepër, duhen ndërmarrë analiza të thelluara sektoriale që do të orientojnë ndërhyrjet rregullatore dhe të politikave të nevojshme për të korigjuar keq shpërndarjen e burimeve dhe jo efikasitetin në nivel sektorial, me fokus të veçantë NVM-të. Rekomandojmë që të krijohen të paktën tre grupe pune ndërministrore me mandat për të kryer analiza sektoriale për produktivitetin, të paktën për sektorin e turizmit, bujqësisë dhe menaxhimit të energjisë dhe mbetjeve. Këto analiza mund të çojnë në koordinimin e politikave për inovacionin, K&ZH, masat fiskale dhe rritjen e bazuar në produktivitetin ekonomik. Analizat e ICC tregojnë se produktiviteti ekonomik mund të përmirësohet me 24 %.*

3.6 REKOMANDIME - INOVACIONI

Rekomandim 6. Sektorët me hapësirë për rritjen e produktivitetit nëpërmjet *produktivitetit të punës* janë energjia, menaxhimi i ujit dhe mbetjeve, ndërtimi dhe pasuritë e paluajtshme. Ne rekomandojmë që këta sektorë të vihen nën fokusin e strategjisë së inovacionit duke nxitur më shumë AI/digjitalizim në mbështetje të produktivitetit të punës.

- *Masat për të zbritur shpenzimet e punës ose për të subvencionuar specialistë shumë të aftë të angazhuar në kërkim dhe zhvillim, ekonomi qarkulluese dhe energji të rinovueshme do të përktheheshin në terma efikasiteti dhe produktiviteti të industrive me intensitet kapital.*

3.7 REKOMANDIME - PRODUKTIVITETI

Rekomandim 7. Sektori i turizmit, prodhimit, industrisë nxjerrëse, si dhe sektori i TIK-ut kërkojnë më shumë kapital për të përshtatur fuqinë punëtore në nivel sektorial dhe për të përmirësuar produktivitetin.


- *Masa rregullatore, standardet e funksionimit apo mbështetja fiskale duke synuar lirimin e fondeve brenda firmave dhe intensifikimin e investimeve kapitale me **fokus investimet inovative dhe të gjelbra**, do t'i çonin këta sektorë drejt një qëndrueshmërie të rritjes së produktivitetit.*

3.8 REKOMANDIME - INOVACION

Rekomandim 8. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të hartojë e të udhëheqë një fushatë ndërgjegjësimi e komunikimi me bizneset e institucionet financiare, për të nxitur më shumë financime dhe investime drejt inovacionit.

- Ekziston një nevojë e madhe për të rritur ndërgjegjësimin e bizneseve/NVM-ve mbi rëndësinë dhe përfitimet e inovacionit dhe K&ZH-së si mënyra për të trajtuar produktivitetin e ulët dhe mungesën e konkurrencës. Masat e politikave që adresojnë K&ZH/novacionin janë intensifikuar, megjithatë, më shumë duhet bërë për të shtyrë një ndryshim organizativ në nivel firme që të nxiten investimet inovative.

Ka ardhur koha që sipërmarrësit të kthejnë sytë drejt rritjes së produktivitet në punë dhe futjes së Inovacionit në cdo sektor të ekonomisë si një faktor thelbësor për forcimin e tyre dhe sigurimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike në vend



Kapacitetet e limituara të kompanive për të përmirësuar teknologjinë dhe për të rritur konkurrueshmërinë në vend e më gjerë, kërkojnë më shumë mbështetje nga ana e politikave fiskale e sektoriale si edhe institucionet financiare

III. PYETJE PËR DEBAT

Informaliteti dhe konkurrenca e pandershme si kufizime thelbësore të tregut

- *Përpyetje në vazhdimësi, por perceptim për rritje të informalitetit (mosdeklarim, mos regjistrim)*
- *Qasje te integruara sektoriale - (rritim cilësinë dhe standardet te rregullojme tregun ne kuader te integrimit ne BE dhe ulim informalitetin (p.sh turizëm, transport- jo aksione....)*

Klima e biznesit dhe problemet sistemike

- *Paparashikueshmëria ligjore dhe institucionale*
- *Kreditimi i shtrenjtë (banka e nivelit të dytë.....)*
- *Skemat e AIDA për investime në teknologji të pezulluara*
- *Kosto në rritje për biznesin e vogël (kosto e certifikates se nenshkrimit elektronik)*
- *Mbyllja e biznesit problem edhe pas kaq shumë vitesh dhe përmirësimesh ligjore*
- *Inspektimet nga inspektoriatet problem në frekuencë dhe cilësi*
- *Siguria e te dhënave (e-Albania)*

III. PYETJE PËR DEBAT

A ka një vizion të konsoliduar dhe të strukturuar mbi politikën dhe mirëadministrimin fiskal?

- *Draft Strategjia Afatmesme për Mbledhjen e të Ardhurave 2022 (“draft strategjia”) e përgatitur në 2021-2022 ende një draft i pamiraturar...*
- *Ka një perceptim të gjerë se fryma e ndryshimeve mund të ketë qenë pozitive POR politikat fiskale të zbatuara kanë qasje për të trajtuar problematika “ad-hoc” dhe jo në funksion të trajtimit të integruar të çështjeve sistemike...(TVSH për qëllime të kompensimit të fermerëve e paqëndrueshme (6%, 14%, 20%, 0 %, 6% etj.)*
- *Politikat fiskale konsiderojnë kryesisht impaktin buxhetor.... Integrimi në BE po sjell edhe sfida të reja për administratën tatimore-trajtimit adekuat të aplikimeve për shmangie të tatimit të dyfishtë....?!*
- *Matja e impaktit të politikave fiskale mbi produktivitetin dhe konkurrueshmërinë nuk ka qasje sektoriale....*

Legjislacioni dhe mirëadministrimi fiskal kushtëzohen nga qëndrueshmëria, koherenca e ndërhyrjeve, kapacitetet e administratës dhe transparencja

- *Legjislacioni “Për Procedurat Tatimore” (24+ amendime/shtesa, mungesë kohezioni në parimet bazë (vetëdeklarim vs rivlerësim), procedura të shpërndara, reforma në vazhdimësi (e-tax/fiskalizim), sistem konfuz i penaliteteve të zbatuara, etj.) A ka ardhur koha për një ligj të ri? Kod Tatimor?*
- *Ligji “Për Tatimin mbi të Ardhurat”- “rregulloi” profesionet e lira, por nuk solli risi për shpenzimet e zbritshme për individët apo trajtimin tatimor në total të të gjitha të ardhurave... Miratimi i ligjit tregoi që administrata nuk ishte gati për t’a zbatuar (p.sh.: Akti normativ për deklaratat e reja në sistem)*
- *Integrimi në BE po sjell edhe sfida të reja për administratën tatimore- trajtimin adekuat të aplikimeve për shmangie të tatimit të dyfishtë....*
- *Ligjet “Për Investimet Strategjike” (2015), “Për TEDA” (2015) dhe “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” (2022)- Cilat janë arritjet, impakti, dështimet dhe mundësitë për përmirësim? A ka një raport mbi arritjen e objektivave dhe mundësitë për përmirësim?*